

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas:

<https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/faq/>

Numri i Gjellbër pa Pagesë:

0800 10 10



Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore:

- | | |
|-------------------------------|---|
| 1. QSHNJP- Tiranë | ndihma.juridike@drejtesia.gov.al |
| 2. QSHNJP- Durrës | ndihmajuridike.durres@drejtesia.gov.al |
| 3. QSHNJP- Fier | ndihmajuridike.fier@drejtesia.gov.al |
| 4. QSHNJP- Shkodër | ndihmajuridike.shkoder@drejtesia.gov.al |
| 5. QSHNJP- Gjirokastrë | ndihmajuridike.gjirokaster@drejtesia.gov.al |
| 6. QSHNJP- Lushnjë | ndihma.juridikelushnje@drejtesia.gov.al |
| 7. QSHNJP- Vlorë | ndihmajuridike.vlore@drejtesia.gov.al |
| 8. QSHNJP- Korçë | ndihmajuridike.korce@drejtesia.gov.al |
| 9. QSHNJP- Tropojë | ndihmajuridiketropoje@drejtesia.gov.al |
| 10. QSHNJP- Përmet | ndihmajuridike.permet@drejtesia.gov.al |
| 11. QSHNJP- Mat | ndihmajuridike.mat@drejtesia.gov.al |
| 12. QSHNJP- Pukë | ndihmajuridike.puke@drejtesia.gov.al |
| 13. QSHNJP- Kavajë | ndihmajuridikekavaje@drejtesia.gov.al |
| 14. QSHNJP- Kurbin | ndihmajuridikekurbin@drejtesia.gov.al |
| 15. QSHNJP- Lezhë | ndihmajuridike.lezhe@drejtesia.gov.al |
| 16. QSHNJP- Pogradec | ndihmajuridike.pogradec@drejtesia.gov.al |
| 17. QSHNJP- Dibër | ndihmajuridike.diber@drejtesia.gov.al |
| 18. QSHNJP- Elbasan | ndihmajuridike.elbasan@drejtesia.gov.al |
| 19. QSHNJP- Berat | ndihmajuridike.berat@drejtesia.gov.al |
| 20. QSHNJP- Kukës | ndihmajuridike.kukes@drejtesia.gov.al |

TË DREJTAT PRONËSORË TË GRAVE

Realizuar në kuadër të Programit të Asistencës Teknike:

“Barazi Gjinore për Akses në Mundësi Ekonomike”

Financuar nga:

Implementuar nga:

In partnership
with





Pse janë të rëndësishme të drejtat pronësore për gratë?

Garantimi i të drejtave pronësore për gratë është thelbësor për realizimin e të drejtave të tyre njerëzore, rrit fuqinë ekonomike të tyre, ul varfërinë, dhe redukton dhunën me bazë gjinore. Duke gëzuar në mënyrë të barabartë me burrat të drejtat pronësore, gratë janë më të sigurtat për të përmirësuar jetesën e tyre dhe të fëmijëve. Gjithashtu, aksesit në pronë dhe pasuri u jep mundësi grave të krijojnë bazën e të ardhurave për ushqim dhe të jenë më të pavarura në menaxhimin e të ardhurave të tyre dhe në marrjen e vendimeve në familje.

A kanë gratë dhe burrat të drejta të barabarta pronësore në Shqipëri?

PO, sipas Kushtetutës, burrat dhe gratë kanë të drejta të barabarta pronësore. **Neni 41 i Kushtetutës** mbron pronën private për të gjithë shtetasit, pavarësisht gjinisë. Gjithashtu, **Kodi i Familjes në Nenin 76 parashikon se pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët**, me përjashtim të rastit kur njeri nga bashkëshortet provon karakterin e saj vetjak. Në këtë kuptim, nëse bashkëshortët kanë blerë një pronë pas lidhjes së martesës, ajo konsiderohet pasuri e përbashkët e tyre, me përjashtim të rastit kur njëri prej bash-

Si ndikon regjistrimi i përbashkët i pronës në të drejtat pronësore të grave?

Regjistrimi i përbashkët i pronës siguron që të dy bashkëshortët të kenë të drejta të barabarta mbi pronën e fituar gjatë martesës. Kjo ndihmon në mbrojtjen e të drejtave të grave dhe parandalimin e diskriminimit gjinor në rast të divorcit ose trashëgimisë.

A mundet bashkëshorti të disponojë banesën bashkëshortore dhe pajisjet e saj pa pëlqimin e bashkëshortes?

JO! Kodi i familjes përcakton se bashkëshortët nuk mund të disponojnë banesën bashkëshortore dhe pajisjet e saj pa pëlqimin e njëri-tjetrit, cilido qoftë regjimi pasuror martesor. **Neni 90 i Kodit të Familjes** parashikon se **kryerja e veprimeve që kapërcejnë administrimin e zakonshëm u takon bashkërisht të dy bashkëshortëve.** Kjo do të thotë që nëse bashkëshortja nuk ka dhënë pëlqimin për shitjen apo lëshimin me qira të banesës bashkëshortore, ajo mund të kërkojë anulimin e çdo veprimi juridik të kryer nga bashkëshorti.

A duhet të vendosin gratë të gjitha pasuritë që kanë fituar përpara martesës në emër të bashkëshortit vetëm për shkak të martesës? A kanë gratë të drejtën për të gëzuar pasuri vetjake sipas ligjit?

Gratë nuk janë të detyruara të vendosin pasurinë e tyre vetjake në emër të bashkëshortit!

Kodi i familjes i njehtë drejtën të gëzojnë lirisht pasurinë që kanë fituar përpara lidhjes së martesës! Për më tepër, ato mund të gëzojnë lirisht edhe pasurinë që kanë fituar gjatë lidhjes së martesës me trashëgimi apo dhurim, pasurinë e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake, pasurinë e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak apo mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit.


A mund të përdorin gratë banesën familjare në pronësi të bashkëshortit pas zgjidhjes së martesës?

PO! **Neni 153 i Kodit të familjes** përcakton se gratë mund t'i kërkojnë gjykatës të përdorin banesën e bashkëshortit në rast se nuk kanë në pronësi një banesë tjetër të përshtatshme për vendbanimin dhe nëse:

- *Fëmijët janë lënë për rritje dhe edukim deri sa të arrijnë moshën madhore.*
- *Zgjidhja e martesës bëhet nga ish-bashkëshorti pronar për ndërprerje prej tij të jetesës së përbashkët. Në këtë rast, e drejta e përdorimit të banesës është deri në 7 vjet nëse gruaja nuk rimartohet brenda këtij afati.*
- *Nëse gruaja ka instaluar në banesën e ish-bashkëshortit pronar një kabinet profesional me vlerë të madhe, lëvizja e të cilit do të kërkonte shpenzime të mëdha. Në këtë rast, e drejta e përdorimit është deri në 3 vjet.*

Cilat janë të drejtat e grave lidhur me pasurinë e paluajtshme të fituar gjatë martesës në rastin e çeljes së trashëgimisë?

Ligji parashikon se gratë kanë të drejta të barabarta në pronësi mbi pasurinë e fituar gjatë martesës. Edhe nëse pasuria është regjistruar vetëm në emër të bashkëshortit tuaj, gratë kanë të drejtën e bashkëpronësisë mbi gjysmën e kësaj pasurie. **Neni 358 i Kodit Civil** parashikon se **bashkëshorti i trashëgimlënësit ka të drejtë të kërkojë pjesën që i takon në pasurinë e përbashkët të fituar me punë nga bashkëshortët gjatë martesës**. Kjo do të thotë që, në momentin e çeljes së trashëgimisë, gratë duhet të sigurohen që pjesa e prezumuar të zbritet nga pasuria trashëgimore, dhe vetëm pjesa që i takon bashkëshortit të jetë objekt i pasurisë trashëgimore. **Si përfundim, gruaja do të jetë pronare e prezumuar në ½ e pasurisë bashkëshortore** dhe do të përfitojë gjithashtu nga ½ e pjesës së bashkëshortit si trashëgimtare e radhës së parë.



A mundet që noteri gjatë lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë të mos njohë pjesën takuese të gruas në pasurinë bashkëshortore?

JO! Neni 112, pika 2 e Ligjit nr.110/2018 "Për Noterinë" parashikon detyrimin e noterit për të parashikuar në aktin e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë të klauzolës se dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, **nuk mund të cenojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës**. Bazuar në Nenin 112, pika 3 e këtij ligji kërkuesi, brenda 30 ditëve duhet të depozitojë në institucionin përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, një kopje të dëshmisë së trashëgimisë. Në çdo rast, noteri duhet detyrimisht t'i bashkëlidhë dëshmisë së trashëgimisë certifikatën martesore të bashkëshortit/bashkëshortes pasjetues/e.



A humbet gruaja të drejtat pronësore në rast të shitjes apo blerjes të një pasurie nëse ajo nuk është prezent gjatë lidhjes së kontratës përpara noterit?

JO! Sipas **Nenit 127 të ligjit për Noterinë** në rastet e tjetërsimit ose njohjes së pronësisë mbi sendet e paluajtshme, noteri i bashkëngjijt aktit përkatës noterial (kontratës të shitjes psh) certifikatën familjare dhe/ose martesore të palës blerëse. **Noteri bën përshkrimin përkatës në kontratë, duke cituar si blerës/bashkëpronar bashkëshorten/in jo prezent**, për shkak të fitimit të të drejtave të pronësisë përgjatë martesës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes.

Në rastin e shitjes së pasurisë së fituar gjatë martesës, ligji parashikon që duhet të merret në çdo rast pëlqimi i gruas edhe në rast se pasuria e fituar gjatë martesës nuk është e regjistruar në emër të të dy bashkëshortëve. Por në këtë rast, nëse pasuria është shitur, atëherë gruaja duhet të drejtohet gjykatës dhe të kërkojë pjesën takuese të përfitimit të pasurisë.

Cilat janë të drejtat e grave lidhur me regjistrimin e pasurive të fituara gjatë martesës në rastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme?

Neni 45/1 i Ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën" parashikon se nëse pasuria, objekt i kontratës së shitjes, realizuar në favor të personave fizikë, të cilët në regjistrin e gjendjes civile kanë statusin e të martuarit, është pasuri e fituar gjatë martesës, në përputhje me nenin 76, të Kodit të Familjes, **regjistrimi në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë bëhet në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve**, për sa kohë ata nuk provojnë se i nënshtrohen një regjimi pasuror martesor të veçantë.

Të njëjtat rregulla zbatohen edhe në rastin e **regjistrimin e pasurive të legalizuara**, si dhe për regjistrimin e **kontratës së sipërmarrjes, porosisë e të premtimit për shitje**, kur këto të fundit synojnë kalimin e pronësisë së objektit në ndërtim, në të ardhmen.

Organizatat Jofitimprurëse të autorizuara të japin shërbime të ndihmës juridike parësore

- Forumi i Gruas Elbasan (FGE): forumigruaselbasan1991@gmail.com
- Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), Tiranë: crca@crca.al
- Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), Tiranë: avokatore2@yahoo.com
- Psiko-Sociale Vatra, Vlorë: info@qendravatra.org.al
- Qendra ALTRI, Tiranë: qendra.altri@gmail.com
- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Tiranë: linjakeshillimit@gmail.com
- Shoqata "Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët" – RMSA, Tiranë: m.hereni@rmsa.al
- Shoqata "Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare Berat": artadyrmishi@hotmail.com
- Qendra e Gruas Hapa të Lehtë, Shkodër: qendragruashk@yahoo.com
- Qendra "Konsumatori Shqiptar", Durrës: qendrakonsumatorishqiptar@gmail.com
- Organizata "Të ndryshëm dhe të barabartë", Tiranë: mmeshi@yahoo.co.uk
- Organizata "Refleksione", Tiranë: info@refleksione.org
- Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD), Tiranë: info@acpd.org.al
- Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI), Tiranë: office@qshpli.org
- Organizata "Shërbimi ligjor falas Tiranë" (TLAS), Tiranë: rbozo@tlas.org.al

A mund të kërkojnë gratë përditësimin e të dhënave kadastrale nëse pasuria e paluajtshme e fituar gjatë martesës është regjistruar vetëm në emër të bashkëshortit?

PO. Bazuar në Nenin 45/2 të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën" gratë kanë të drejtë të kërkojnë korigjimin ose përditësimin e të dhënave kadastrale për pasuritë e paluajtshme në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve, të fituara gjatë martesës. Kjo do të thotë që, nëse pasuritë e paluajtshme të përfituara me blerje, pjesëtim, shkëmbim, sipërmarrje, porosi, premtim shitje, legalizim janë pasuri të përfituara gjatë martesës dhe të regjistruara në kadastër vetëm në emrin e njërit bashkëshort, bashkëshorti tjetër ka të drejtë të kërkojë korigjimin e kartelës dhe regjistrimin e pasurisë në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve në pjesë të barabarta.

Në çdo rast kërkesa duhet të bëhet nga bashkëshorti që nuk është i regjistruar dhe të shoqërohet me çertifikatën e gjendjes familjare në kohën kur është fituar pasuria. Kërkesa bëhet online nëpërmjet shërbimit e-albania.

A rregullohet në të njëjtën mënyrë edhe instituti i bashkëjetesës? A gëzojnë gratë të njëjtat të drejta pronësore si në rastin e regjimit martesor?

JO! Bazuar në Kodin Civil, pasuria e pajuatshme e fituar gjatë bashkëjetesës në emrin vetëm të njërin bashkëjetues, nuk prezumohet pasuri e përbashkët e të dy bashkëjetuesve, edhe pse gruaja mund të ketë kontribuar në fitim e kësaj pasurie. Bazuar në nenin 164 të kodit Civil, personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës.

A mund të ndryshojnë gratë regjimin pasuror me kontratë?

PO! Kontrata martesore është një kontratë që lidhet me vullnetin e lirë të bashkëshortëve, përmes së cilës ata mund të krijojnë, ndryshojnë, shuajnë një regjim pasuror midis tyre. Përmes kësaj kontrate, bashkëshortët mund të zgjedhin një prej regjimeve pasurore që gjejnë rregullim në kodin e familjes (regjimin e pasurive të ndara, bashkësisë me kontratë). Gjithashtu, përmes kontratës, mund të modifikojnë regjimin ligjor të pasurisë, rregullat e administrimit të pasurisë, të përcaktojnë pjesët takuese të pasurisë apo të ndryshojnë rregullat e pjesëtimit të pasurisë në përputhje me interesat e tyre ekonomike apo interesin më të lartë të familjes.

Ku mund të drejtohen gratë për ndihmë juridike dhe këshillim për të drejtat pronësore?

Gratë mund të drejtohen tek Qendrat e Ndihmës Juridike falas dhe organizatat për të drejtat e grave për ndihmë juridike dhe këshillim mbi të drejtat pronësore.